



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E FINANCAVE

Mars 2017

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Prill

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nëntor

Dhjetor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Mars 2017

© Ministria e Financave, 2017

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: eva.doda@financa.gov.al
vivi.besho@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin mars 2017 arriti në 104.67 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin mars 2017 ishte 2.1 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin mars 2017 ishte 126.74 lekë për dollarë dhe 135.38 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit mars 2017 shënuan kuotën 0.90 për qind për ato 12 –muajore; 0.58 për qind për depozitat 6-mujore; 0.28 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.97 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 6.71 për qind për huatë 12-mujore dhe 8.44 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 1,242,996 milionë lekë në muajin mars, duke shënuar një rritje prej rreth 3 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave* për tremujorin e katërt të 2016-ës shënoi rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 153.3 milion euro.
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar-mars 2017 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 6.3 miliardë lekë, që do të thotë se janë mbledhur rreth 4.0 miliardë lekë më shumë se planifikimi për këtë periudhë (ndërkohë që deficitin ishte planifikuar 2.3 miliona lekë).
- *Të ardhurat* gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar-mars 2017, arritën në rreth 101.5 miliardë lekë ose afërsisht 105 për qind e planit për këtë periudhë.
- *Shpenzimet* gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 95.1 miliardë lekë ose 101 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.


Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin mars 2017 ishte 2.1 %. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte 0.3 %.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin mars 2017 shënoi rritje prej 0.4 për qind krahasuar me muajin paraardhës. Ky indeks ka shënuar gjithashtu rritje edhe për muajt shkurt e janar 2017 me përkatësisht 0.5 dhe 0.9 për qind në krahasim me muajt parardhës përkatës. Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin mars 2016 shënoi gjithashtu rritje prej 0.5 për qind në krahasim me muajin paraardhës. Ndërsa në muajt shkurt dhe janar 2016, indeksi i çmimeve të konsumit shënoi përkatësisht rritje me 1.1 për qind dhe 0.9 për qind në krahasim me muajt paraardhës përkatës.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin: “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me një rritje vjetore të çmimit prej +3,3% duke kontribuar me +1,39 pikë përqindje; “Transporti” me një rritje vjetore të çmimit prej +3,8%, duke kontribuar me +0,22 pikë përqindje ; “Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me një rritje vjetore të çmimit prej +1,1%, duke kontribuar me +0,22 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2,1%.



Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupi që pati kontributin më të ulët në inflacionin e përgjithshëm ishte “Veshje dhe Këpucë” me një rënie vjetore të çmimit prej -0,7%, duke ndikuar negativisht me -0,03 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2,1%. Ndryshimi mujor i indeksit është +0,4%. Krahasuar me muajin Shkurt 2017 rritja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Transporti” me +1,0 %. Ulja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me -0,2%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2016	1.5	0.2	0.3	0.3	0.7	1.2	1.9	2.0	1.8	1.5	1.9	2.2
2017	2.8	2.2	2.1									

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin mars 2017, arriti në 135.38 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 0.15 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit mars, një euro u këmbye me 136.13 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin mars 2017 arriti në 126.74 lekë/dollarë duke shënuar rënie me 0.54 për qind kundrejt muajit shkurt 2017. Në fund të muajit mars, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 127.34 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin mars të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 2.05 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 1.75 për qind. Nënçmimi i lekut kundrejt monedhës evropiane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.94 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitetet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave


Gjatë muajit mars 2017, normat e interesit të depozitave me afat 12-mujor shënuan nivelin prej 0.90 për qind, pasuar nga ato me afat 6-mujore që arritën kuotën 0.58 për qind. Normat e interesit të depozitave me afat 3 dhe 1-mujore shënuan përkatësisht kuotat 0.28 dhe 0.97 për qind. Normat e interesit të depozitave 12 dhe 6 mujore në lekë kanë shënuar rënie në krahasim me muajin e mëparshëm, ku rënia më e madhe 0.20 pikë përqindje vihet re tek normat e interesit me afat maturimi 6-mujor. Ndërsa normat e interesit të depozitave 3 dhe 1 mujore kanë shënuar rritje mujore prej përkatësisht 0.01 dhe 0.29 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë shënuar normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 6 dhe 3-mujore me përkatësisht 0.17 ; 0.20 dhe 0.11 pikë përqindje. Rritje vjetore kanë shënuar vetëm normat e interesit me afat 1-mujor me 0.48 për qind.

Interesi i huave 6 dhe 12 mujore gjatë muajit mars 2017 arritën përkatësisht kuotën prej 8.44 dhe 6.71 për qind duke shënuar rënie mujore prej 0.16 për qind. Norma e interesit të huave 6 dhe 12-mujore shënuan gjithashtu rënie vjetore prej 0.84 dhe 0.76 për qind.

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit mars 2017, për bonot 6 dhe 12-mujore ishin përkatësisht 1.7 dhe 2.25 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rënie mujore të këtyre *yield*-ve të bonove të thesarit dhe rënien më të madhe e kanë shënuar ato 12-mujore me 0.68 për qind.


Fig. 3



Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4



Normat e interesit për huatë dhe bonot



Burimi: Banka e Shqipërisë

4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të vitit 2016 shënoi rritje të mjetëve valutore, me rreth 153.3 milionë euro. Tremujori i katërt i 2016-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 240.3 milionë euro, në tkurrje referuar të njëjtës periudhë në një vit më parë me rreth 40%. Deficiti tregtar u ngushtua me rreth 23%, në nivelin 437 milionë euro, dhe përbën faktorin kryesor në përmirësimin e deficitit korrent. Flukset e kapitalit, shuma e tepricave nën zërin “Llogaria kapitale” dhe “Llogaria financiare”, regjistruan një pozicion neto negativ prej rreth 253.0 milionë euro. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.


Gjatë periudhës transaksionet në llogarinë korrente vlerësohen rreth 2,556 milionë euro dhe janë zgjeruar me 6% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente shënon 240.3 milionë euro, rreth 40% më i ulët krahasuar me një vit më parë. Përmirësimi i deficitit korrent i atribuohet edhe një zgjerimi më të ngadaltë në deficitin tregtar në gjysmën e dytë të vitit, pas një rritje të konsiderueshme të tij (29% në terma vjetorë) në gjashtëmujorin e parë – për efekt të së bashku, rënies më të ngadaltë të eksporteve dhe importeve të ulëta në projektet e lidhura me investime në sektorin energjetik. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesore përbërës (në terma neto) për vitin 2016 (Fig-6):

- (i) bilanci tregtar me -666.5 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 229.6 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me 27.8 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 224.4 milionë euro.




5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit mars 2017, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 87,414 milionë lekë krahasuar me muajin mars të vitit 2016. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 22,784 milionë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë të me rreth 64,631 milionë lekë.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1,248,316 milionë lekë në muajin mars 2017, duke shënuar rritje prej rreth 42,108 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 3.5 për qind. Në muajin mars 2017, sistemi bankar rezulton me një rënie prej 11,958 milionë lekë ose 0.9 për qind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin janar 2017.




6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin mars 2017 arriti në rreth 547,431 milionë lekë. Teprica e kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 355 milionë lekë, pra rritje prej rreth 0.06 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 52.3 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 286,374 milionë lekë.

Gjatë muajit mars 2017, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 62.3 për qind ose 340,847 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 30.94 për qind ose 169,402 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.97 dhe 1.67 për qind apo 27,197 dhe 9,168 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin mars 2017, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 50.57 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 38.43 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 72.93 për qind dhe rreth 24.12 për qind.


Fig-9



Rritja e stokut total të kredive

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-10




Përberja e kredive Mars '17

Burimi: Banka e Shqipërisë

7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 244,558 milionë lekë në fund të muajit mars 2017. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në mars 2017 ka shënuar rritje mujore prej 0.08 për qind si dhe rritje vjetore prej 1.16 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rritje mujore prej 0.13 për qind dhe rritje vjetore prej 1.8 për qind.

Fig-11




Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin mars 2017, kanë pësuar rënie prej 11,325 milionë lekë në krahasim me muajin mars 2016. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 85.7 për qind të tyre. Ndërsa depozitat në valutë gjatë muajit mars 2017 shënuan rritje prej 25,949 milionë lekë, mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 82.6 për qind të depozitave në valutë.

Fig-12



Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve


Gjatë muajit mars 2017, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 85.7 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 10.5 për qind dhe nga “Korporata të tjera financiare” me 1.7 për qind.

“Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 82.6 për qind dhe rreth 15.5 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 85.7 për qind e totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 839,270 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (130,862 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (13,999 milionë lekë) dhe “Korporata jofinanciare publike” (12,259 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 2,048 milionë lekë në totalin e depozitave.

Gjatë muajit mars 2017, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën 998,439 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 5,301 milionë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 14,624 milionë lekë.


Fig-13



Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-14



Përberja e depozitave Mars 2017

Burimi: Banka e Shqipërisë


Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-mars 2017 janë mbledhur rreth 101.5 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 95.1 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 84.8 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 10.2 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 69% janë financime të brendshme.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 69.9 miliardë lekë (ose rreth 107% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushtetit vendor rreth 3.8 miliardë lekë (ose rreth 90% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 20.3 miliardë lekë (ose rreth 105% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 5.5 miliardë lekë (ose rreth 112% e planit të periudhës janar-mars 2017).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 84.8 miliardë lekë, 16.5 miliardë lekë (20% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 7.8 miliardë lekë (9%) për interesat, 8.6 miliardë lekë (10.2%) për



shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 242 milionë lekë (0.3%) për subvencione, 35.2 miliardë lekë (41.6%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 8.9 miliardë lekë (10.5%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 5.2 miliardë lekë (6.1%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 22% (shpenzime personeli), 19% (shpenzime për interesat), 19% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 10% (subvencione), 23% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 22% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 22% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 15%, ndërsa financimi i huaj është 12% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-mars 2017 ishin rreth 101.5 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 94.5 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 5.5 miliardë lekë.

Tab - 2

*Të ardhurat gjatë periudhës Janar-Mars 2017 (mld Lekë)
Revenues during January-March 2017 (in billion ALL)*

Burimi (Source)	Mars '17 February '17	Mars '16 February '16	Ndrysh(% Chang (%)
TVSH (VAT)	31.3	29.9	4.5
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	11.1	10.7	3.6
Taksa doganore (Custom Tax)	1.3	1.3	4.0
Taksat nacionale (National Tax)	8.6	7.4	16.1
Akcizat (Excise)	9.2	8.5	7.6
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	7.6	7.9	-3.8

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Maj – 2017;

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: May – 2017;

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 6.3 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Mars 2017, u përdor kryesisht për pagesën e maturimit të huamarrjes së brendshme (rreth -15.5 miliardë lekë) dhe për huanë afatgjatë të huaj (rreth 2.9 miliardë lekë).

Për muajin mars 2017, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 37.464 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 39.326 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin mars 2017, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat arrijnë shifrën e 27.1 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 32.1 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 7.1 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2012	2013	2014	2015	2016	2017	
Janar	0.7	1.0	0.8	1.4	0.9	1.5	0.7	1.00	0.8	1.4	0.9	0.9	1.6	2.7	1.7	1.3	1.5	2.8	January
Shkurt	1.3	1.1	1.4	2.4	1.1	0.5	1.0	1.05	1.1	1.9	1.0	1.0	0.6	2.5	1.9	2.3	0.2	2.2	February
Mars	0.4	0.2	0.5	0.4	0.5	0.4	0.8	0.77	0.9	1.4	0.8	0.8	1.0	2.4	2.2	2.2	0.3	2.1	March
Prill	-0.1	-0.1	-0.6	-0.5	-0.4		0.6	0.55	0.5	0.9	0.5		1.6	2.3	1.7	2.3	0.3		April
Maj	-0.8	-1.0	-1.1	-1.6	-1.2		0.3	0.24	0.2	0.4	0.2		1.9	2.1	1.6	1.8	0.7		May
Qershor	-0.8	-0.6	-0.7	-1.1	-0.6		0.1	0.15	0.1	0.1	0.04		2.2	2.3	1.5	1.4	1.2		June
Korrik	-0.2	-0.8	-0.6	-0.7	0.05		0.1	-0.03	0.0	0.2	0.33		2.7	1.6	1.8	1.3	1.9		July
Gusht	0.4	-0.1	0.1	0.8	0.86		0.1	-0.04	0.0	0.1	0.32		2.8	1.2	2.0	1.9	2.0		August
Shtator	0.2	0.8	0.3	0.6	0.40		0.1	0.06	0.0	0.2	0.17		2.6	1.7	1.5	2.2	1.8		September
Tetor	0.2	0.1	0.1	0.01	-0.2		0.1	0.05	0.0	0.2	0.13		2.4	1.7	1.4	2.1	1.5		October
Nëntor	0.2	-0.5	-0.2	-0.3	0.1		0.1	0.01	0.0	0.1	0.12		2.5	1.0	1.7	2.1	1.9		November
Dhjetor	0.9	1.7	0.7	0.6	0.9		0.2	0.15	0.1	0.17	0.19		2.4	1.9	0.7	2.0	2.2		December

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2013	2014	2015	2016	2017			Currency
					Janar	Shkurt	Mars	
					January	February	March	
<i>Mesatarja e periudhës</i>					<i>Average of period</i>			
USD	105.67	113.64	126.64	128.29	128.40	127.43	126.74	USD
EURO	140.27	140.11	137.65	135.27	136.57	135.59	135.38	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>					<i>In the end of period</i>			
USD	101.86	115.23	125.79	128.17	127.37	127.45	127.34	USD
EURO	140.20	140.14	137.28	135.23	136.39	135.08	136.13	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

	2013	2014	2015	2016	2017			
Në përqindje					Janar	Shkurt	Mars	In percent
					January	February	March	
Norma e depozitave								Deposits rates
12-M	4.17	1.51	1.27	0.78	0.69	0.94	0.90	12-M
6-M	3.40	1.16	1.17	0.78	0.57	0.78	0.58	6-M
3-M	2.72	0.83	0.54	0.27	0.31	0.27	0.28	3-M
1-M	2.79	1.47	0.88	0.87	0.86	0.68	0.97	1-M
Norma e huasë								Lending rates
12-M	9.52	7.00	7.47	4.54	6.27	6.87	6.71	12-M
6-M	9.59	8.18	8.35	7.01	9.74	8.60	8.44	6-M
Norma e letrave me vlerë								Securities rates
Bono thesari 1/								Treasury bills 1/
3-M	3.40	3.15	-	-	1.22	-	-	3-M
6-M	3.54	3.16	2.46	2.00	2.25	2.01	1.70	6-M
12-M	3.66	3.33	2.40	2.92	3.20	2.93	2.25	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Nr.	E M Ë R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	32,893	64,020	101,510	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	186	618	1,371	Grands
II.	Të ardhura tatimore	30,935	59,660	94,551	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	22,022	42,806	69,995	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,146	20,237	31,302	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,620	3,827	11,177	Profit Tax
3	Akcizat	2,727	5,730	9,242	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,185	5,414	7,663	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,930	6,734	9,252	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	414	864	1,359	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	907	2,398	3,866	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	195	410	774	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	2	8	31	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	710	1,980	3,061	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	8,006	14,456	20,690	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	6,743	12,238	17,537	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,146	1,970	2,780	Health insurance
III.	Të ardhura Jotatimore	1,772	3,742	5,588	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë		0		Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,320	2,900	4,108	Income of budgetary institutions
	TOTALI I SHPENZIMEVE	25,029	54,609	95,116	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	24,033	51,613	84,833	Current Expenditures
I.1	Personeli	5,476	10,992	16,585	Personnel expenditures
1	Paga	4,700	9,451	14,257	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	776	1,541	2,328	Social insurance contributions
I.2	Interesat	2,830	5,570	7,823	Interest
1	Të Brendshme	2,078	4,190	5,909	Domestic
2	Të Huaja	752	1,380	1,914	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,567	4,502	8,630	Operational & Maintenance
I.4	Subvecionet	55	108	242	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	11,285	22,716	37,429	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	8,645	17,397	27,010	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,640	5,319	8,284	Health insurance
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	1,789	4,855	8,914	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,031	2,870	5,210	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	41	74	108	Unemployment insurance benefits
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca		0		Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	1,239	3,091	10,228	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	118	1,246	7,086	Domestically financing
2	Financimi Huaj	1,121	1,845	3,142	Foreign financed
IV	Detyrimet e prapambetuara		0		Arrears
V.	DEFICITI	7,864	9,411	6,394	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-7,864	-9,411	-6,394	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-8,392	-19,666	-15,516	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	4	24	123	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	7,474	8,681	11,187	Domestic new borrowing (net)
10	Të tjera (detyrime të përkohshme)	-105	-268	-109	Other-Float
V.3	I huaj	528	10,255	9,122	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	1,473	1,931	2,924	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nënhua	391	768	1,128	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-312	69	13	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-811	-1,793	-3,863	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	178	10,048	10,048	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

Tabela e investimeve 2017

Table of investments 2017

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
Financim i brendshëm	118	1,246	7,086	Domestic financing
<i>Në %</i>	9.52	40.31	69.28	<i>In %</i>
Financim i huaj	1,121	1,845	3,142	Foreign financing
<i>Në %</i>	90.48	59.69	30.72	<i>In %</i>
Totali	1,239	3,091	10,228	Total
<i>Në %</i>	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2017
CUSTOMS REVENUES 2017**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
Taksë doganore	414	864	1,359	Customs Duties
TVSH	5,775	13,085	22,069	V.A.T
Akcizë	2,727	5,730	9,242	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	250	438	585	Others (Mineral Rent)
TOTALI	9,166	20,117	33,255	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2017 (TAX REVENUE)

TVSH	4,370	7,151	9,233	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,620	3,827	11,177	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,185	5,414	7,663	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	3,680	6,296	8,667	National taxes
TOTALI	12,855	22,688	36,740	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	22,021	42,805	69,995	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2017

The Deficit and Its Financing for 2017

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	Shkurt February	Mars Mar	
TË ARDHURAT	32,893	64,020	101,510	REVENUE
SHPENZIMET	25,029	54,609	95,116	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	7,864	9,411	6,394	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-7,864	-9,411	-6,394	FINANCING
Financimi i brendshëm	-8,392	-19,666	-15,516	Domestic
a. Bono Thesari Neto	358	1,341	1,237	Treasury bills
b. Obligacione	7,127	7,359	9,978	Bonds
c. <i>Ndryshimi i gjëndjes së arkës</i>	-7,056	-11,934	-378	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	-7,661	-12,766	1,103	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	605	832	-1,481	Deposit of Social & Health Ins.
Mjete në ruajtje	372	-1	-703	Non-budget revenues
Të ardhura nga privatizimi	4	24	123	Privatization receipts
Të tjera detyrime (të përkohshme)	-105	-268	-109	Others
Huamarrje Brendshme Vendori	-10	-19	-28	Local Borrowing
Financimi i jashtëm	528	10,255	9,122	Foreing
a. Hua afatgjatë	1,473	1,931	2,924	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	-312	69	13	Chang. of stat. Account
Ripagesat	-811	-1,793	-3,863	Repayments
Mbeshtetje Buxhetore	178	10,048	10,048	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2013	3M_I 2014	3M_II 2014	3M_III 2014	3M_IV 2014	Viti 2014	3M_I 2015	3M_II 2015	3M_III 2015	3M_IV 2015	3M_I 2016	3M_II 2016	3M_III_2016	3M_IV_2016	
Llogaria korente	-1,026.70	-271.50	-341.00	-313.20	-377.50	-1,303.20	-261.60	-174.40	-327.10	-397.40	-223.70	-359.50	-206.20	-240.30	Current Account.
Bilanci tregtar	-1,729.30	-426.20	-511.40	-560.70	-638.30	-2,136.60	-488.90	-488.50	-616.00	-705.40	-579.30	-677.00	-680.00	-666.50	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	1,731.50	212.40	264.90	228.80	219.20	925.30	172.00	250.50	177.20	171.40	125.50	194.30	172.60	221.30	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,460.80	-638.60	-776.30	-789.50	-857.50	-3,061.90	-660.90	-739.00	-793.20	-876.80	-704.80	-871.30	-852.60	-887.80	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	8.90	30.00	38.10	97.90	102.40	268.40	94.00	127.90	139.70	141.20	176.00	121.90	269.10	229.60	Services Balance.
Shërbimet Kredi	1,655.00	396.40	487.10	610.00	538.00	2,031.50	421.50	455.40	607.90	543.40	483.00	522.90	754.20	635.60	Services Credit
Shërbimet Debi	-1,646.10	366.40	449.00	512.10	435.60	1,763.10	305.4	327.50	468.2	402.20	307	401.00	485.1	406.00	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	-8.40	-20.60	-43.30	-48.70	-47.00	-159.60	-47.40	-24.10	-27.30	-34.20	10.50	-21.30	-5.50	-27.80	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	193.30	28.70	25.80	28.30	27.80	110.60	27.20	24.60	30.30	43.90	50.80	38.10	42.50	45.70	Income Credit
Të ardhurat Debi	-201.70	-49.30	-69.10	-77.00	-74.80	-270.20	-74.60	-48.70	-57.60	-78.10	-40.30	-59.40	-48.00	-73.50	Income Debt
Bilanci i transfertave	702.10	145.30	175.60	198.30	205.40	724.60	180.70	210.30	176.50	201.00	169.10	216.90	210.20	224.40	Balance of Transfers
Transferta private	681.40	172.60	204.40	230.60	244.20	851.80	211.90	243.30	219.10	247.20	205.00	250.10	250.70	255.40	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	20.70	-27.30	-28.80	-32.30	-38.80	-127.20	-31.20	-33.00	-42.60	-46.20	-35.90	-33.20	-40.50	-31.00	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	47.70	22.50	22.40	20.70	21.10	86.70	26.00	21.30	45.60	32.80	6.60	7.20	3.10	49.40	Capital Account
Llogaria financiare	775.60	-161.90	-184.20	-363.00	-247.20	-956.30	-279.1	-208.1	-426.6	-412.4	-121.0	-255.3	-33.9	-302.4	Financial Account
Investime direkte	893.10	-168.00	-150.40	-253.50	-229.40	-801.30	-257.70	-211.30	-234.00	-120.00	-148.10	-233.60	-295.80	-280.90	Direct Investment
Investime portofoli	-103.70	14.50	14.00	-12.40	104.70	120.80	-74.70	-66.80	-11.20	-172.10	106.00	-10.90	0.60	108.90	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	-13.80	-8.40	-47.80	-97.10	-122.50	-275.80	109.20	106.10	-183.20	-120.60	-8.00	24.70	295.50	-130.60	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	315.30	49.90	104.20	86.40	70.50	311.00	46.20	-38.80	167.10	121.50	46.70	97.20	113.10	41.80	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	111.90	-37.20	-30.20	156.90	-38.70	50.80	55.90	36.10	-1.80	169.30	-49.40	0.20	-56.10	153.30	Overall Balance
						0.00									
Rezervat	-104.40	-40.30	22.50	154.00	-39.00	97.20	111.80	16.20	312.50	169.10	-49.60	0.00	-56.10	153.30	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-7.80	-3.20	52.80	-2.90	-0.30	46.40	55.90	36.10	-1.80	-0.30	70.90	35.50	34.20	-0.20	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 9

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhes	2013	2014	2015	2016	2017			Millions of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
Mjetet valutore neto	274198.1	292,098.3	365,663.3	389,612.7	372,032.3	377,986.6	393,476.1	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	294111.3	318,940.2	407,654.7	418,562.1	401,162.8	406,288.9	422,972.2	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	19913.2	26,841.9	41,991.5	28,949.4	29,130.5	28,302.3	29,496.1	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	67841.8	82,525.1	63,394	65,915.7	58,978	42,093	42,755	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	44503.1	55,198.3	48,752	34,255.6	23,305	12,091	14,642	Claims on Central Government
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	66768.8	71,831.3	75,143.9	53,279.9	53,157.7	52,670.0	5,256.9	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	22265.7	16,633.0	26,391.9	19,024.3	29,852.7	40,578.8	37,920.5	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera deponituese	21502.9	25,547.8	12,237.0	29,934.4	33,947.4	28,282.5	26,382.8	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	37.3	-	-	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1835.8	1,741.7	1,648.9	1,725.7	1,725.1	1,718.9	1,729.6	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	308073.7	332,899.3	383,972.8	414,380.9	388,321.4	377,934.1	392,977.2	Monetary Base
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	787.9	1,093.8	451.8	194.0	195.1	194.2	188.8	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	1309.8	14.8	34.2	47.2	14.0	13.8	35.7	Other accounts payable
Të tjera neto	-14102.8	-15,170.5	-18,792	-20,953.6	-21,044	-21,004	-20,968	Other items net
Aksione	45,971.3	55,786.1	63,391.1	61,859.9	63,523.0	62,940.8	63,996.8	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 10 KREDIA PËR EKONOMINË
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2013	2014	2015	2016	2017			Million of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
Totali i kredisë	547927.6	559,986.7	546,873	547,602.4	545,232.8	545,799.0	547,431.1	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale	256	777.7	887.7	845.5	838.3	834.1	816.5	Credits to local Government
Në lekë	256	777.7	887.7	845.5	838.3	834.1	816.5	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	24961	27,328.1	27,419.7	26,863.9	26,880.1	26,943.5	27,197.4	Credits to Public Non-financial Corporations
Në Lekë	20251.4	22,402.3	22,326.1	23,993.9	23,745.5	23,947.0	23,762.9	in Lek
Në valutë	4709.6	4,925.8	5,093.6	2,870.0	3,134.6	2,996.5	3,434.5	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare private	363541.2	372,166.5	355,725.2	343,483.0	340,254.3	341,042.7	340,846.6	Credits to other Non-financial Corporations
Në Lekë	122944.7	129,429.4	129,233.7	131,743.5	130,970.3	131,244.4	132,005.8	in Lek
Në valutë	240596.5	242,737.1	226,491.5	211,739.5	209,284.0	209,798.3	208,840.8	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	9578.2	8,270.3	9,537.7	8,687.6	9,113.6	9,058.7	9,168.2	Credits to Other Financial Corporations
Në Lekë	4238.4	3,436.9	5,036.2	4,242.3	4,136.7	4,242.0	4,155.5	in Lek
Në valute	5339.8	4,833.4	4,501.5	4,445.3	4,976.9	4,816.7	5,012.7	in Foreign Currency
Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë	149591.2	151,444.1	153,303.1	167,722.4	168,146.5	167,920.0	169,402.4	Claims to other Resident Sectors
Në Lekë	72242.5	77,396.7	83,319.7	98,722.3	99,010.8	99,452.4	100,316.8	in Lek
Në valutë	77348.7	74,047.4	69,983.4	69,000.1	69,135.7	68,467.6	69,085.6	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

OFERTA E PARASË

Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2013	2014	2015	2016	2017			Millions of LEK End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
Baza monetare	308,073.7	332,899.3	383,972.8	414,380.9	388,321.4	377,934.1	392,977.2	Base Money
Ndryshimi vjetor në %	3.5	8.1	15.3	1.1	1.0	1.0	1.1	Y/Y change in %
Paraja jashtë korporatave deponituese	198,892.7	217,665.6	239,218.1	249,256.5	249,376.5	254,979.4	254,232.6	Currency Outside Depository
Ndryshimi vjetor në %	3.2	9.4	9.9	4.2	5.9	8.9	8.9	Y/Y change in %
Depozita	950,088.4	977,420	687,292.6	737,808	737,314.5	730,274.3	830,490.2	Deposits
Ndryshimi vjetor në %	2.1	2.9	-29.7	7.3	8.0	7.0	21.1	Y/Y change in %
Agregati M1	295,876.5	353,321.7	384,106.9	435,432.3	430,698.1	424,698.9	424,990.1	M1 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	5.2	19.4	8.7	13.4	14.9	13.1	12.6	Y/Y change in %
Agregati M2	693,172.2	722,356.7	723,975.7	736,944.1	729,179.3	722,303.2	718,785.5	M2 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	3.5	4.2	0.2	1.9	2.5	2.1	1.6	Y/Y change in %
Agregati M3	1,148,980.9	1,195,086.3	1,218,101.2	1,263,453.8	1,260,274.0	1,248,315.8	1,242,996.4	M3 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	2.3	4.0	1.9	3.9	4.2	3.7	3.1	Y/Y change in %
Burimet e bazës monetare								Monetary Base sources
Mjetet e huaja neto	274,198.1	292,098.3	365,663.3	389,612.7	372,032.3	377,986.6	393,476.1	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	67,841.8	82,525.1	63,394.2	65,915.7	58,977.5	42,092.5	42,754.8	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	44,503.1	55,198.3	48,752.0	34,255.6	23,305.0	12,091.1	14,642.4	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera deponituese	21,502.9	25,547.8	12,987.1	29,934.4	33,947.4	28,282.5	26,382.8	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2013	2014	2015	2016	2017			Millions of Leks End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
Në lekë	494,279.5	504,691	493,374	487,687	483,032	477,727	474,228	In national currency
Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë	96,983.9	135,656	153,506	186,176	184,551	179,853	180,432	Transferable deposits+Liquid deposits
Qeveria lokale	1,305.0	2,047.5	1,473.8	1,907.5	1,826.2	1,689.8	1,836.8	Local governments
Korporata jofinanciare publike	6,108.2	9,799.5	8,736.2	6,786.0	6,919.6	6,897.1	6,718.3	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	937.0	1,919.8	1,258.9	2,071.0	2,235.0	2,137.9	2,148.0	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	24,244.0	38,198.6	40,993.6	46,051.0	45,209.7	42,024.8	41,910.3	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	64,389.7	83,690.6	101,043.0	129,360.4	128,360.4	127,103.0	127,818.7	Other resident sectors
Depozita të tjera	397,295.6	369,035	339,869	301,512	298,481	297,874	293,796	Other deposits
Qeveria lokale	57.1	7.8	29.9	18.9	18.9	19.0	19.0	Local governments
Korporata jofinanciare publike	1,257.8	1,167.9	815.0	976.8	1,027.5	953.7	1,343.7	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	2,556.5	1,730.1	3,573.4	7,553.4	7,336.3	8,194.5	5,832.9	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	14,523.4	11,772.0	11,292.1	6,502.2	6,702.1	7,689.6	7,921.1	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	378,900.8	354,357.3	324,158.3	286,460.2	283,396.3	281,017.5	278,678.8	Other resident sectors
Në valutë	455,808.9	472,729	193,918	250,121	254,283	252,547	356,263	In foreign currency
Qeveria lokale	372.6	231.3	209.5	366.1	196.5	175.1	192.3	Local governments
Korporata jofinanciare publike	4,486.2	7,099.6	3,645.4	2,999.4	2,767.9	2,886.9	2,186.1	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	6,673.1	4,872.9	2,641.2	1,815.4	2,433.7	2,153.3	2,470.2	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	49,382.3	55,834.3	53,618.9	73,325.0	74,624.4	73,744.3	175,707.0	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	394,894.7	404,691.2	133,803.4	171,614.8	174,260.0	173,587.8	175,707.0	Other resident sectors
Totali	950,088.4	977,420	687,293	737,808	737,315	730,274	830,490	Total
Qeveria lokale	1,735	2,286.6	1,713.2	2,292.5	2,041.6	1,883.9	2,048.1	Local governments
Korporata jofinanciare publike	11,852.2	18,067.0	13,196.6	10,762.2	10,715.0	10,737.7	10,248.1	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	10,166.6	8,522.8	7,473.5	11,439.8	12,005.0	12,485.7	10,451.1	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	88,149.7	105,804.9	105,904.6	125,878.2	126,536.2	123,458.7	225,538.4	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	838,185.2	842,739.1	559,004.7	587,435.4	586,016.7	581,708.3	582,204.5	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2013	2014	2015	2016	2017			Millions of Lek End of period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
AKTIVET	398,814	433,878	516,358	524,731	511,198	510,119	524,771	
Total	40,652	51,880	126,386	131,887	121,931	129,427	143,303	Total
Mbajtjet e SDR	10,508.0	19,299.7	30,578.8	27,211.8	25,003.0	34,992.5	33,472.7	SDR holdings
Arka në valutë	57.3	56.2	84.9	52.0	27.1	145.1	35.2	Foreign currency
Depozitat	30,086.2	32,524.0	95,722.4	104,622.9	96,900.5	94,289.2	109,795.4	Deposits
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	308,387	320,745	323,679	315,113	307,742	305,361	306,608	Securities other than shares
Jorezident	243,178.6	256,796.7	270,453.6	261,877.5	254,698.0	252,842.0	254,116.5	nonresidents
Qeveria qendrore	65,208.4	63,947.9	53,225.5	53,235.2	53,044.0	52,518.9	52,491.3	central government
Huatë	23,333	27,286	14,641	31,660	35,672	30,001	28,112	Loans
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	21,502.3	25,547.8	12,987.1	29,934.4	33,947.4	28,282.5	26,382.8	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,830.9	1,738.5	1,654.0	1,725.9	1,725.0	1,718.3	1,728.7	Other resident sectors
Derivatet financiare	31.5	17.4	27.7	15.8	15.7	16.7	16.4	Financial derivatives
Llogari të arketueshme	11,994.1	18,197.8	32,741.6	25,094.1	24,917.2	24,434.6	25,891.7	Receivable accounts
Mjetet jofinanciare	14,416.4	15,752.1	18,882.5	20,961.2	20,919.9	20,879.3	20,839.8	Nonfinancial assets
DETYRIMET	398,814	433,878	516,358	524,731	511,198	510,119	524,770	LIABILITIES
Total	208,042	226,588	241,006	262,031	259,938	259,119	256,063	Total
Para në qarkullim	207,792.7	226,434.1	239,218.1	258,848.0	256,854.9	254,979.4	254,232.6	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	249.7	154.2	1,787.9	3,183.2	3,082.8	4,139.8	1,830.1	Deposits included in broad money
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	132,765	140,569	201,586	191,380	178,188	179,335	194,750	Deposits excluded from broad money
Jorezident	9,706.5	16,564.1	31,826.2	19,860.9	19,797.8	19,780.0	19,757.2	Nonresidents
Qeveria qendrore	22,239.2	16,600.5	26,340.8	18,975.1	29,811.6	40,545.4	37,889.2	Central government
Korporata të tjera depozituese	100,031.3	106,310.9	142,966.8	152,349.7	128,383.6	118,814.9	136,914.4	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	62.5	85.0	87.4	72.1	73.3	72.5	72.9	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	725.4	1,008.8	364.4	121.9	121.9	121.7	116.0	
Huatë	2,919	2,294	1,810	314	274	231	232	-
Jorezidentët	2,919.3	2,294.2	1,809.6	314.2	273.9	231.1	232.3	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
Llogari të pagueshme	1,828.3	886.8	461.1	1,164.6	1,256.9	483.1	1,680.6	Other accounts payable
Alokimi i SDR	7,287.5	7,753.2	8,104.4	7,981.2	8,018.1	8,010.4	8,048.2	SDR allocation
Aksione dhe instrumenta të tjerë	45,971.3	55,786.1	63,391.1	61,859.9	63,523.0	62,940.8	63,996.8	Shares and other equity